



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

KE.nr.1791/2022

Lidhja (C.nr. 9105/21)

GJYKATA KOMERCIALE - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Alajdin Tërshnjaku me bashkëpunëtoren profesionale Yllka Pajaziti Abdullahu, në çështjen juridike civile të paditësve – Grupi i Operatorëve Ekonomik: Rexha Sh.P.K., Benita Company Sh.P.K dhe Arhiko ING me seli në Prishtinë (me lider Rexha Sh.P.K.), kundër të paditurit Komuna e Prishtinës me seli në Prishtinë, Rr. Uçk Nr.2, për shkak të padisë për mos përmbushje të kontratës, jashtë seancës në datën 26.09.2022 nxjerrë këtë:

A K T G J Y K I M

(NË BAZË TË HEQJES DORË NGA KËRKESËPADIA)

- I. REFUZOHET e pabazuar kërkesëpadia e paditësve Grupi i Operatorëve Ekonomik: Rexha Sh.P.K., Benita Company Sh.P.K dhe Arhiko ING me seli në Prishtinë (me lider Rexha Sh.P.K.), e datës 19.06.2019, me të cilën kanë kërkuar që te detyrohet e paditura Komuna e Prishtinës që në emër të mos përmbushjes së Kontratës dhe mos pagesës së punëve të pa parapara dhe punëve shtesë t'i paguajë paditësve shumën në vlerën e përgjithshme 73'247.22 si dhe në emër të fitimit të humbur shumën 25'389.51 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore 8% të llogaritur prej datës së pranimit të aktgjykimit në afat prej 7 ditësh, nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.
- II. Secila palë ndërgjyqëse i bartë shpenzimet e veta të shkaktuara në këtë procedurë.

A r s y e t i m

Paditësit: Grupi i Operatorëve Ekonomik: Rexha Sh.P.K., Benita Company Sh.P.K dhe Arhiko ING me seli në Prishtinë (me lider Rexha Sh.P.K.), kanë parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prishtinës për shkak të mos përmbushjes së kontratës për ekzekutimin e punëve për ndërtimin e rrugës Barilevë – Besi, kontratë kjo e lidhur me datën 01.10.2015.

Lidhur me këtë çështje gjykata ka zhvilluar shqyrtimin përgatitor dhe ka mbajtur seanca me palët ndërgjyqëse.

Gjykata ka pranuar parashtrësën e paditësve në datën 07.09.2022, të cilët përmes përfaqësuesit ligjor të liderit të grupit të operatorëve ekonomik – Samir Rexha e kanë njoftuar gjykatën se bëjnë tërheqje të padisë dhe kërkesë padisë së datës 19.06.2019, sipas të cilës është kërkuar përmbushja e kontratës, punëve të pa parapara dhe punëve shtesë.

Gjykata, bazuar në nenin 3 paragrafin 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), ka vlerësuar se palët në këtë procedurë, mund të disponojnë lirisht me kërkesat e tyre juridiko civile që i kanë parashtruar gjatë procedurës, andaj pasi që janë plotësuar kushtet e nevojshme ligjore, ka marr aktgjykim në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia siç është vendosur në pikën I të dispozitiviti të këtij aktgjykimi.

Meqenëse paditësit e kanë tërhequr kërkesëpadinë para përfundimit të shqyrtimit kryesore të kësaj çështje juridike, siç përcaktohet më nenin 149 paragrafi 1 i LPK-së, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses.

Gjykata, bazuar në nenin 149 paragrafi 2 i LPK-së, nuk e ka njoftuar të paditurën paraprakisht pasi që sipas dispozitës së lartcekur, nuk është i nevojshëm pëlqimi i të paditurës, kur paditësi heqë dorë nga kërkesëpadia.

Në bazë të nenit 160 paragrafi 6 të LPK-së, në pjesën arsyetuese të këtij aktgjykimi, Gjykata ka dhënë arsye vetëm për justifikimin e dhënies së këtij lloji të aktgjykimit.

Vendimin për shpenzimet e procedurës, gjykata e bazoi në nenin 450 të LPK-së, me ç'rast e ka vendosur që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Në bazë të dhënave si ma lartë, si dhe në bazë të neneve 142,143,160 si dhe 149 të Ligjit për procedurën kontestimore, u vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.1971/2022, dt.26.09.2022

Gj y q t a r i
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomen e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë